



## Bashkëpunimi për të parandaluar korrupsionin



“3M” është e përkushtuar ndaj kryerjes së veprimtarisë së saj me integritet, pa ndikim nga korrupsione apo ryshfete të çfarëdo natyre. Si një prej partnerëve tanë të çmuar të punës, ne presim të veproni me forma ligjore dhe etike në gjithçka që bëni. Informacioni në këtë broshurë shpjegon pritshmëritë dhe përkushtimin tonë për të punuar me ju në mënyrë që të garantojmë kryerjen e veprimtarisë sonë siç duhet.

3M Compliance & Business Conduct  
3M Center, St. Paul, MN 55144  
USA

[www.3M.com/businessconduct](http://www.3M.com/businessconduct)

© 3M 2016. All rights reserved

## Vizioni i “3M”

Në “3M”, ne vlerësojmë marrëdhëniet tona me partnerët tanë të punës. Pavarësisht vendit ku ndodheni apo produkteve a shërbimeve që ofroni, ju luani një rol kyç në përpjekjet tona për të arritur vizionin tonë.

### Our Vision

3M Technology Advancing Every Company

3M Products Enhancing Every Home

3M Innovation Improving Every Life



## Përkushtimi i “3M” për të luftuar ryshfetin

“3M” e zhvillon veprimtarinë e saj me forma etike dhe në pajtim jo vetëm me ligjet e SHBA-së, por edhe të të gjitha shteteve në të cilat veprojmë. “3M” zgjedh me kujdes partnerë pune që ndajnë vlerat tona dhe përkushtimin tonë ndaj integritetit. Pritshmëria jonë është që veprimtarinë e punës ta kryeni pa ryshfet dhe pa korrupsion.

Kur ryshfeti dhe korrupsioni eliminohen nga procesi i punës, çdo kompani konkurren në bazë të teknologjisë, produkteve dhe shërbimit të klientit. Në një fushë të barabartë loje, gjithsecili ka shanse të barabarta për ta fituar punën me nder!

Parandalimi i ryshfetit dhe i korrupsionit është mënyra e drejtë. Është gjithashtu dhe punë e mbarë. Si pjesë e kodit tonë, “Parimi i ‘3M’ kundër ryshfetit” siguron që të pajtohemi me ligjet botërore kundër korrupsionit, duke përfshirë ligjin “Për praktikën e huaja korruptive” e SHBA-së, ligjin “Për ryshfetin” e Mbretërisë së Bashkuar dhe legjislacionin e të gjitha shteteve ku veprojmë.

## Pritshmëritë e “3M” në lidhje me ryshfetin

“3M” ndalon ryshfetin dhe korrupsionin në të gjitha format, pavarësisht zakoneve dhe praktikave të punës që mund të ekzistojnë në shtete të caktuara dhe presim që dhe partnerët tanë të punës të pajtohen me të gjitha ligjet.

- Ryshfeti si për persona privatë, punonjës të kompanive private dhe nëpunës shtetërorë është kundër ligjeve në fuqi dhe kundër kodit të sjelljes së “3M”.
- Ryshfeti mund të marrë shumë forma, si p.sh. dhurata të tepruara, argëtim dhe udhëtime, kontribute bamirësie, haraçe, donacione politike ose edhe pagesa të vogla për lehtësim punësh.



- Favoret apo premtimet, si p.sh. ofertat për të marrë në punë të afërm të nëpunësve shtetërorë apo për të ofruar ulje të pamerituara për të tjerë mund të konsiderohen gjithashtu si ryshfet dhe të shkelin kodin tonë si dhe ligjet në fuqi.

## Mënyra e veprimit e “3M”

Në “3M” ka vetëm një mënyrë veprimi në punë, mënyra e drejtë. Kodi ynë i sjelljes u jep punonjësve të “3M” dhe partnerëve të punës që veprojnë për llogari të “3M” udhëzime të qarta për marrjen e vendimeve të mira etike çdo ditë. Kodi ynë i sjelljes dhe parimi kundër korrupsionit mund të lexohen te [www.3M.com/businessconduct](http://www.3M.com/businessconduct)

“3M” ka një historik të gjatë efikasiteti të lartë dhe veprimtarish të nivelit botëror falë reputacionit të jashtëzakonshëm të kompanisë sonë dhe punës së njerëzve tanë. Së bashku ne ndikojmë në mënyrën si kryhet puna në nivel botëror duke njohur rregullat, duke bërë zgjedhjet e duhura dhe duke kërkuar udhëzime nëse kemi shqetësime apo nëse nuk jemi të sigurt si të veprojmë.

- “3M” është anëtare e “United Nations Global Compact (UNGC)” dhe e “UNGC Working Group on the Tenth Principle”.
- “3M” është shpallur në vitin 2016 nga “Ethisphere” si një prej “World’s Most Ethical Companies ®” (kompanitë më etike të botës) për vitin e tretë me radhë.
- “3M” është njohur si një prej kompanive më të admiruara të botës (Fortune).
- “3M” është një nga kompanitë më të respektuara të botës (Barron’s).

## Pyetje

Kjo është një fushë komplekse dhe dinamike ligjore; nëse keni pyetje për informacionet që përmban kjo broshurë ose nëse dyshoni për sjellje të pahijshme, lidhuni me personin tuaj të kontaktit në “3M” ose me departamentin e pajtueshmërisë dhe të sjelljes në punë të “3M”, ose vizitoni faqen [3M-Ethics.com](http://3M-Ethics.com).

